



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 49  
Prishtinë, më 15.12. 2009, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**P R O C E S V E R B A L**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Morën pjesë:** Ismet Beqiri – kryetar, Radmila Vujovic, Drita Maliqi  
Nerxhivane Dauti, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli ,Danush  
Ademi.

**Munguan:** Hajredin Hyseni dhe Shpresa Murati, ishin të zënë me punë zyrtare

**Mbledhjen e mbikëqyrën:** Rrezarta Ahmeti – KDI, Xhemajl Ahmeti - UNHCR dhe  
Elita Vokshi e Lejla Selimi - OSBE.

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Rrahim Demaj – koordinator dhe Visar  
Krasniqi.

***Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet, në bazë të Rregullores së punës të  
Kuvendit të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë:*

**R E N D I T E**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Njoftim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për moszbatimin e vendimeve të KPMK -së nga disa institucione shtetërore,
3. Analiza e vizitës studimore të zhvilluar në Poloni,
4. Njoftim për propozimplanin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian (pika që e ngarkon Komisionin),
5. Të ndryshme.

***Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.***

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.**

*Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.*

## **2. Njoftim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për mos zbatimin e vendimeve të KPMK- së nga disa institucione shtetërore**

**Ismet Beqiri-** I njoftoi për shkresën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, që ka të bëjë me moszbatimin e vendimeve. Tha se Komisioni ka mbajtur takim më 21. 7. 2009, ku ishte i pranishëm z. Bajram Azemi, anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe ka debatuar për moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, me qëllim të gjetjes së mënyrës së zbatimit.

Mirëpo u pajtua që për këtë çështje të kërkohet një seancë e veçantë dhe paraprkisht Komisioni i kërkon KPMK - së që t'i dërgojë raport Kuvendit të Kosovës dhe në bazë të tij të kërkohet që në njërën nga seancat plenare të zhvillohet debat. Gjithashtu kërkon nga KPMK - ja listën e institucioneve që nuk i zbatojnë vendimet e këtij këshilli.

**Ibrahim Makolli** – Vërejtjet ia adresoi KPMK - së që me kohë nuk i ka sjellë të dhënat kur është diskutuar Raporti i KPMK - së në Kuvend. Prandaj, sipas tij, ka të bëjë me dy çështje: E para, kjo është shkelje e të drejtave të njeriut dhe e dyta kemi të bëjmë me moszbatim të vendimeve të autoriteteve të pavarura, çka e vënë në pikëpyetje arsyeshmërinë e ekzistimit të një institucioni të tillë. Në vazhdim theksoi: se nëse vendimet e tij nuk zbatohen, a është ky një mashtrim i madh që u bëhet nëpunësve civilë? U pajtua që kjo çështje të kërkohet dhe të futet në rend të ditës në një seancë plenare dhe të kërkohet material shtesë nga KPMK - ja. Lidhur me këtë pikë u pajtua Komisioni që në mbledhjen e radhës të debatohet dhe të përgatiten rekomandimet që do t'i dërgohen kryesisë së Kuvendit duke kërkuar lejimin e një seance plenare.

**Drita Maliqi** – u pajtua me parafolësi lidhur me moszbatimin e vendimeve të KPMK – së dhe shtoi : Komuna e Gjilanit prin me numër të punëtoreve të larguar nga mardhenia e punës dhe largimi i tyre është bërë për shkaqe politike.

## **3 Analiza e vizitës studimore të zhvilluar në Poloni,**

**Ismet Beqiri,** kryetar - I njoftoi me takimin që e zhvilloi Komisioni me përfaqësuesit e Organizatës për Institucionet Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe me Komisionin për Legjislacion dhe për të Drejtat e Njeriut të Parlamentit të Polonisë në Varshavë, duke i falënderuar për mirëpritjen e treguar.

Në vazhdim tha se u debatua për temat si vijon:

- Toleranca dhe jodiskriminimi,
- Demokratizimi dhe sundimi i ligjit,
- Personi kontaktues për komunitetin rom dhe **siniti**,
- Të drejtat e njeriut,
- Tryezë e rrumbullakët (Çështja gjinore, politikat dhe opsionet legjislative),
- Tryezë e rrumbullakët (Legjislacioni dhe standardet e të drejtave të njeriut),
- Tryezë e rrumbullakët (Draftimi i legjislacionit / çështjet diskriminuese, me theks të veçantë në diskriminimin në baza gjinore),

**Drita Maliqi** – tha se kur flitet për ODIHR-in mendohet për zgjedhjet dhe për të drejtat e njeriut., vizita studimore në Poloni është vlerësuar e suksesshme .

#### **4 Njoftim për propozim planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian (pika që e ngarkon Komisionin ),**

Komisioni diskutoi për propozim planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian. Raporti i Progresit për vitin 2009 prezanton të arriturat e Kuvendit në miratimin e rezolutës për prioritet dhe strategjitë e Kosovës për integrim evropian. Pra, në raportin e vitit 2009 paraqet mungesat e kapaciteteve të Kuvendit që kanë të bëjnë me shqyrtimin e projektligjeve, monitorimin e implementimit pas miratimit të tyre – sfidë e përsëritur nga raporti 2008. Prandaj Komisioni do të zotohet në përmbushjen e aktiviteteve të parapara me planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës, ku kërkohet nga Komisioni të përfshijë në agjendën e takimeve pikën që e ngarkon.

**Nerxhivane Dauti** – Duke u ndërlidhur me Raportin e Progresit për vitin 2009, e ngriti çështjen e Projektligjit për personat e pagjetur dhe zvarritjen e tij e vlerësoi të patolerueshme, kur dihet nevoja e ligjit. Njëkohësisht kërkoi nga OSBE - ja të organizojë një vizitë studimore të Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione në Bosnje – Hercegovinë, siç tha ajo me qëllim që të njihemi më për afërmi me teknikat e hartimit të ligjit përkatës.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 25

Kryetari i Komisionit

-----  
*Ismet Beqiri*